



This project is funded by
the European Union



50
YEARS

Empowered lives. Resilient nations.

DISKUTIM PËR PRINTIMIN 3D DHE ARMËT E ZJARRIT

Hyrje

Printimi tredimensional (3D), i njohur edhe si prodhim aditiv (AM) është një teknologji nëpërmjet së cilës shtresa të njëpasnjëshme materiali shtrohen njëra mbi tjetrën nën kontrollin e kompjuterit dhe rezultati final është një objekt tredimensional.¹ Printerët 3D kanë dalë në treg që nga viti 2010 me një çmim që varion nga 1000 USD deri në 1 milion USD dhe janë përdorur për një sërë industrish, duke përfshirë industrinë

automobilistike, aerohapësinore, arkitekturore, atë të mbrojtjes dhe zëvendësimeve mjekësore. Shumë prej këtyre sistemeve janë përdorur, dhe përdoren ende, për krijimin e shpejtë të prototipeve përpara përdorimit të metodave të prodhimit në masë. Megjithatë, kohët e fundit çmimi i printerëve 3D është ulur në më pak se 1000 USD. Me uljen e çmimit të printerëve 3D, ata në mënyrë të natyrshme u bënë më të aksesueshëm për vetëprodhimin e produkteve të ndryshme personale, duke përfshirë armët e zjarrit.

Përgjatë viteve të fundit termi printim 3D njihet edhe si një metodë relativisht e lehtë për të prodhuar armët e zjarrit, duke shtuar kështu shqetësimet se kjo mund të rrisë përhapjen e tyre, pasigurinë dhe të furnizojë terrorizmin.²

¹ Çfarë është printimi 3D, <http://3dprinting.com/what-is-3d-printing/> Marrë më 30 tetor 2016
Printimi 3D, <http://explainingthefuture.com/3dprinting.html>, Marrë më 30 tetor 2016.
Çfarë është printimi 3D? Udhëzues përcaktues për prodhimin aditiv. <https://www.3dhubs.com/what-is-3d-printing,printing>, Marrë më 30 tetor 2016.

² "Si të prodhosh një armë në shtëpi" *The Wall Street Journal* <http://www.wsj.com/articles/how-to-make-a-gun-at-home-1477610554>, 27 tetor, 2016 (parë më 1 nëntor 2016)

Duke qenë se në Ballkanin Perëndimor ende nuk është regjistruar ndonjë rast i prodhimit të armëve të zjarrit ose pjesëve të tyre përbërëse nëpërmjet printerëve 3D, kjo teknologji nuk përbën ndonjë rrezik të konsiderueshëm ose të menjëhershëm për rajonin. Megjithatë, me zhvillimin e shpejtë të teknologjisë së printimit 3D, uljen e çmimeve të printerëve 3D e të materialeve që ai përdor dhe me shfaqjen në treg të materialeve të reja dhe të përmirësuara, është shumë e rëndësishme që autoritetet të njihen me aftësitë e kësaj teknologjie dhe të monitorojnë situatën për të qenë në gjendje që të reagojnë siç duhet në të ardhmen.

Qëllimi i këtij informacioni është që të informojë politikëbërësit për zhvillimet dhe sfidat që paraqet printimi 3D i armëve të zjarrit dhe që të nisë një diskutim për ndryshimet e nevojshme ligjore dhe të politikave për të luftuar këtë kërcënim real dhe të mundshëm. Gjithashtu, informacioni supozohet që të nxisë diskutimet dhe të paraqesë shembuj që mund të jenë të zbatueshëm për Ballkanin Perëndimor, me qëllim që të çojë në ndryshimet e nevojshme ligjore dhe të politikave.

Metodat dhe teknologjitë e prodhimit aditiv

Fillimisht, termi printim 3D i referohej metodave që depozitojnë material sipas një rendi të caktuar mbi një shtrat pluhuri nëpërmjet kokave të printerëve që lëshojnë bojë. Kohët e fundit, kuptimi i këtij termi përfshin një larmi më të madhe teknikash, si procesi i nxjerrjes dhe procesi me bazë pjekjen. Tani janë të disponueshme një numër i madh metodash aditive. Ato kryesisht ndryshojnë në mënyrën sesi depozitohen shtresat për të krijuar pjesët përkatëse dhe në materialet që përdorin. Standardet teknike zakonisht përdorin termin prodhim aditiv për këtë spektër të gjerë teknikash.³

Cilësia dhe kompleksiteti i dizajneve të printerëve, si dhe cilësia e produkteve të përfunduara kanë shumë ndryshim. Printerët që punojnë direkt me metale përgjithësisht janë të kushtueshëm. Megjithatë, për të bërë një armë zjarri mund të përdoren printerë më pak të kushtueshëm.

Zakonisht, modelet që mund të printohen në 3D mund të krijohen nëpërmjet programeve të dizajnit në kompjuter (CAD) që gjenden në treg. Ndërtimi i një modeli mund të kërkojë nga disa orë deri në disa ditë, në varësi të metodës që përdoret dhe përmasës dhe kompleksitetit të modelit. Pasi krijohet në CAD, një softuer i veçantë e konverton modelin dixhital 3D në një sërë shtresash të holla dhe prodhon një skedar dixhital që përmban udhëzimet përfundimtare të printimit, të përshtatura me llojin specifik të printerit 3D. Me fjalë të tjera, ky softuer, i cili është i lidhur me një printer 3D, e udhëzon printerin gjatë gjithë procesit të printimit.

Zhvillimi i printerit 3D paraqet një sërë sfidash, si p.sh. kontrollin e prodhimit të palicencuar të armëve të zjarrit, zbatimin e kufizimeve për skedarët dixhitalë në internet që lidhen me armët e zjarrit, diktimin dhe gjurmueshmërinë e armëve të zjarrit të printuara me teknikën 3D, zbatimin e kufizuar të teknikave mjeko-ligjore etj.

³ Për detaje të mëtejshme shih: Christopher Barnatt, 3D Printing, 2 Edition, 7 November 2014, CreateSpace Independent Publishing Platform, 306 pages
Printimi 3D i njohur edhe si prodhimi aditiv (AM), <http://www.onlineblueprintprinting.com/index.php/2016/08/23/3d-printing/>, Marrë më 1 nëntor 2016.

Konsiderimet në lidhje me

printimin 3D dhe armët e zjarrit

Në vitin 2012, një grup me qendër në SHBA, Defense Distributed, shpallën planet e tyre për të vënë në dispozicion të publikut planet e dizajnit për një armë, të cilët mund të shkarkoheshin lehtësisht dhe mund të përdreshin për të prodhuar një armë nëpërmjet një printeri të çfarëdoshëm 3D. Pak pas kësaj, Defence Distributed përbushi premtimin e bërë dhe publikoi në faqen e tij të internetit skemat për prodhimin e një arme me teknologjinë 3D. Reagimi i qeverisë së Shteteve të Bashkuara ishte shumë i shpejtë, duke i kërkuar që të hiqte menjëherë këto skema.⁴ Ndonëse qeveria e

**Në shumë vende janë hartuar
kuadrot ligjore për kontrollin ose
ndalimin e prodhimit të armëve
të zjarrit të paregjistruara dhe
nevojiten vetëm rregullime të
vogla për të garantuar lehtësisht
dhe plotësisht konsiderimin e
keqpërdorimit të teknologjisë 3D
si shkelje.**

Shteteve të Bashkuara e kishte detyruar kompaninë që të hiqte skemat, ato u shpërndanë gjerësisht nëpërmjet The Pirate Bay dhe faqe të tjera interneti për shpërndarjen e skedarëve.

Në vitin 2014, një i ri nga Japonia u bë personi i parë në botë që futej në burg për shkak se kishte prodhuar armë zjarri nëpërmjet teknikës 3D. Arsyeja e arrestimit ishte mbajtja e armëve të printuara me teknikën 3D në kundërshtim me ligjin "Për kontrollin e armëve të zjarrit dhe shpatave". Po ashtu, në Japoni prodhimi i armëve të zjarrit pa leje është i paligjshëm dhe bie në kundërshtim me ligjin "Për prodhimin e lëndëve plasëse". Ai vendosi në internet skema dhe udhëzime me video për prodhimin e një arme, dhe për pasojë u dënua me dy vjet burg. Policia gjeti në shtëpinë e tij të paktën dy armë që mund të qëllonin plumba.⁵

Duke qenë se konsumatorët e kanë më të lehtë të gjejnë printerë 3D, përdorimi i tyre për prodhimin e armëve të zjarrit gjithashtu mund të rritet. Ky zhvillim paraqet një sërë sfidash, duke përfshirë sfidat për kontrollin e prodhimit të palicencuar, duke vendosur kufizime për skedarët dixhitalë që lidhen me armët e zjarrit në internet, sfidën e gjurmueshmërisë së armëve të zjarrit të printuara me teknikën 3D, përdorimin e kufizuar të teknikave të mjekësisë ligjore etj.

Një sërë faqesh interneti u vënë në dispozicion përdoruesve informacione për mënyrën sesi të ndërtojnë një printer 3D, ndërsa ka faqe të tjera të posaçme për shpërndarjen e modeleve 3D. Forume në mediat sociale organizojnë diskutime për mënyrën e përmirësimit të cilësisë së printimit 3D dhe shkëmbejnë lajme për printimin 3D. Shkëmbimi i këtyre informacioneve mund të lehtësojë procesin e prodhimit të armëve të zjarrit. Gjithashtu, printimi 3D së bashku me teknologjitë e re ve kompjuterike lejon prodhimin e armëve të zjarrit pavarësisht zonave gjeografike.

4 Defense Distributed, DD History, <https://defdist.org/dd-history/>, Marrë më 1 nëntor 2016.
Defense Distributed, DD History, <https://defdist.org/ddvus/>, Marrë më 1 nëntor 2016.
Independent, James Legge, E premte 10 maj 2013, <http://www.independent.co.uk/news/world/americas/us-government-orders-cody-wilson-and-defense-distributed-to-remove-blueprint-for-3d-printed-handgun-8610842.html>, Marrë më 1 nëntor 2016.
Arstechnica, <http://arstechnica.com/tech-policy/2016/09/court-groups-3d-printer-gun-files-must-stay-offline-for-now/>, Marrë më 1 nëntor, 2016.

5 Xinhua, Burri japonez arrestohet për mbajtje të armëve të prodhuara me teknikën 3D, 8 maj 2014, <http://www.shanghaidaily.com/world/Japanese-man-arrested-for-possessing-3D-printer-guns/shdaily.shtml>, Marrë më 3 nëntor 2016; dhe James Vincent, Burri japonez dënohet me dy vjet burg për krijimin e armëve nëpërmjet teknikës 3D, The Independent, 21 tetor 2014, <http://www.independent.co.uk/life-style/gadgets-and-tech/japanese-man-jailed-for-two-years-for-creating-3d-printed-guns-9807765.html>, Marrë më 3 nëntor 2016.

Në maj të vitit 2013, Departamenti Amerikan i Sigurisë së Brendshme dhe Qendra e Përbashkët Rajonale e Zbulimit pranuan këtë rrezik kur nxorën një memorandum ku deklarohet se “përparimet e konsiderueshme në aftësitë e printimit tredimensional (3D), disponueshmëria e skedarëve dixhitalë pa pagesë që mund të printohen në 3D për pjesë të armëve të zjarrit dhe vështirësitë në rregullimin e shkëmbimit të skedarëve mund të përbëjnë rreziqe për sigurinë publike nga persona të pakualifikuar që kërkojnë armë, të cilët marrin ose prodhojnë armë të prodhuara me teknikën 3D”⁶

Për sa i përket sigurisë publike dhe mbrojtjes, një sfidë që mund të jetë e vështirë lidhet me armët plastike të zjarrit që janë **të padiktueshme** dhe rregulloret kërkojnë që të gjitha armët e zjarrit duhet të kenë të paktën një komponent kryesor që diktohet nga detektorët tipikë të metalit⁷. Në SHBA, ligji parashikon se çdo armë zjarri që prodhohet, blihet, shitet ose transportohet duhet të ketë një sasi të caktuar metali në brendi të saj, në mënyrë që të diktohet nga detektorët e metalit. Ndaj, armët e

Autoritetet praktikisht e kanë të pamundur që të kontrollojnë materialet që përdorin printerët 3D për prodhimin e armëve të zjarrit, duke qenë se po këto materiale përdoren për prodhimin e të gjitha produkteve të tjera për konsumatorin.

6 Jana Winter, Buletini i Departamentit për Sigurinë e Brendshme paralajmëron se armët e printuara në 3D mund të jenë të pamundura për t'u ndaluar, FoxNews, 23 maj 2013, <http://www.foxnews.com/us/2013/05/23/govt-memo-warns-3d-printed-guns-may-be-impossible-to-stop.html>, Marrë më 20 tetor 2016.

7 Disa teste kanë treguar se armët e printuara me teknikën 3D, edhe kur përmbajnë elemente metali, kanë kaluar detektorët e metalit për kontroll personash, megjithëse ato janë diktuar nga skanerët me rreze X që përdoren në aeroporte. (Burimi: Përmbledhje e kryetarit në mbledhjen e dytë të ekspertëve qeveritarë të programit të veprimt kundër armëve të vogla dhe të lehta 2015)

zjarrit të printuara në 3D mund t'u shpëtojnë këtyre masave të kontrollit duke e rritur kështu rrezikun që ato përfaqësojnë.

Konsiderime ligjore

Aktualisht asnjë vend në botë nuk ka një kuadër ligjor plotësisht të përgatitur për kërcënimet e mundshme që shoqërojnë armët e printuara me teknikën 3D, duke ngritur kështu pikëpyetje për atë çka mund të ndryshohet në legjislacionin ekzistues.

Për sa i përket **prodhimit**, legjislacioni i propozuar në disa vende për ndalimin e prodhimit të armëve nëpërmjet teknikës 3D mund të pengojë, por jo të ndalojë plotësisht prodhimin e tyre. Edhe pse legjislacioni i ri e ndalon këtë praktikë, kontrolli i shpërndarjes në internet të këtyre skedarëve dixhitalë mund të jetë i vështirë, njësoj si kontrolli i programeve kompjuterike ose skedarëve të muzikës që tregtohen në mënyrë të paligjshme. Disa ligjvënës në SHBA kanë propozuar që të vendosen **rregullore për printerët 3D** me qëllim që të ndalohet përdorimi i tyre për të printuar armë. Megjithatë, mbrojtësit e printimit 3D kanë sugjeruar që këto rregullore jo vetëm që do të ishin të kota, por do të dëmtonin industrinë e printimit 3D, për të mos përmendur shkeljen e së drejtës së lirisë së fjalës.

Çështja e armëve të printuara me teknikën 3D gjithashtu mund të shikohet në këndvështrimin e **legjislacionit të eksportit/importit** dhe nëse armët e printuara me teknikën 3D duhet ose jo të përfshihen në listat e kontrollit të eksportit, si Lista e përbashkët ushtarake e Bashkimit Evropian.⁸ Kjo do të nënkuptonte që, pavarësisht qëndrueshmërisë së artikullit të prodhuar dhe materialit të përdorur për prodhimin e tij (metal, plastikë, qeramikë), nëse një armë zjarri e prodhuar nëpërmjet procesit të printimit 3D përmbush parametrat e një kategorie përkatëse të kontrolluar (si ML1 që kontrollon armët pa vjaska me një kalibër më të vogël se 20 mm dhe armët e vogla dhe ato automatike me një

8 Lista e përbashkët ushtarake e Bashkimit Evropian e miratuar nga Këshilli më 14 mars 2016; Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian C122/2016, <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=OJ:C:2016:122:TOC>, 6 prill 2016.

kalibër 12,7 mm ose më të vogël), ajo duhet të mbulohet nga lista e kontrollit.⁹

Gjithashtu, është e rëndësishme të theksohet se nga këndvështrimi i **legjislacionit për eksportin**, “të dhënat teknike” për prodhimin e një arme të kontrolluar rregullohen nga kategoria ML22 që lidhet me teknologjinë në Listën e përbashkët ushtarake të Bashkimit Evropian¹⁰. Sipas listës së përmendur të kontrollit, **“të dhënat teknike” mund të marrin formën e projekteve, planeve, diagrameve, modeleve, formulave, tabelave, skicimeve dhe specifikimeve inxhinierike, manualeve dhe udhëzimeve të shkruara ose të regjistruara në mjete të tjera komunikimi ose pajisje, si disk, shirit, memorie vetëm për lexim.** Në këtë drejtim, autoritetet kompetente duhet të vlerësojnë nëse përkufizimet në listën e kontrollit mbulojnë siç duhet teknologjinë e printimit 3D. Për Ballkanin Perëndimor, procesi i anëtarësimit në BE nënkupton se autoritetet duhet të ndjekin nga afër zhvillimet në nivel BE-je dhe të vazhdojnë të harmonizojnë politikat. Megjithatë, duke qenë se procesi i harmonizimit me listën e përbashkët ushtarake të Bashkimit Evropian mund të kërkojë nga tre deri në nëntë muaj në vendet e Ballkanit Perëndimor, do të ishte mirë që autoritetet

Sipas listës së përbashkët ushtarake të Bashkimit Evropian, “të dhënat teknike” mund të marrin formën e projekteve, planeve, diagrameve, modeleve, formulave, tabelave, skicimeve dhe specifikimeve inxhinierike, manualeve dhe udhëzimeve të shkruara ose të regjistruara në mjete të tjera komunikimi ose pajisje, si disk, shirit, memorie vetëm për lexim.

rajonale të mos presin, por të kërkojnë mekanizmat më efektive dhe më efikase të kontrollit që janë të disponueshme në juridiksionin e tyre.

Dhe në fund, por jo për nga rëndësia, ekziston një çështje shumë delikate në lidhje me mbajtjen e “të dhënave teknike” në lidhje me armët. Aspekti i vetëm që është nën një kontroll relativ në fushën e printimit 3D është eksport-importi i këtyre të dhënave. Përkatësisht, të gjitha “të dhënat teknike” të nevojshme për prodhimin e armëve të zjarrit që nuk përfshihen në listë (d.m.th. armët pa vjaska që përdoren për qëllime gjuetie ose sporti) mund të keqpërdoren lehtësisht. Gjithashtu, është e qartë se ky aspekt i kontrollit nuk është i përshtatshëm për dy arsye të tjera. Së pari, lista e përbashkët ushtarake e BE-së mbulon vetëm eksportin dhe importin e “të dhënave teknike” të një arme të kontrolluar, por megjithatë nuk ekziston asnjë kontroll ose sanksionim nëse një sipërmarrës novator zhvillon dhe shpërndan “të dhëna teknike”, qoftë edhe të armëve të kontrolluara, për sa kohë që skedarët shpërndahen brenda kufijve të juridiksionit ku ai sipërmarrës banon. Në këtë rast, përveçse kur nuk ka arsye për të vërtetuar eksportin ose importin e të dhënave, personi që e shpërndan këtë skedar nuk kryen asnjë shkelje. Së dyti, duke parë legjislacionin aktual, mbajtja e “të dhënave teknike” për prodhimin e armëve të zjarrit nuk konsiderohet aspak si shkelje. Në fakt, derisa kundërvajtësi të kryejë një shkelje duke e printuar një armë zjarri ose duke e përdorur atë dhe kapet gjatë këtij akti, mbajtja ose ndarja e “të dhënave teknike” nuk përbën shkelje penale për sa kohë që të dhënat nuk kalojnë kufirin. Për rrjedhojë, autoritetet e rajonit duhet të përipiqen të trajtojnë këtë hapësirë ligjore.

9 Po aty.

10 Teknologji - Informacioni specifik i nevojshëm për “zhvillimin”, “prodhimin” ose “përdorimin”, instalimin, mirëmbajtjen (kontrollin), riparimin, remontin ose rinovimin e një produkti. Informacioni jepet në formën e “të dhënave teknike” ose “ndihmës teknike”.

Vëzhgimet

kyçe për diskutim.

Për momentin, **besueshmëria** e armëve të zjarrit të printuara me teknikën 3D nuk është shumë e lartë; armët e printuara me teknikën 3D zakonisht bëjnë shumë pak shtimje. Megjithatë, duhet theksuar se qoftë edhe një qitje e vetme përbën një kërcënim. **Zbatimi i kufizuar i teknikave mjeko-ligjore** dhe lehtësia për **t'i asgjësuar** këto armë gjithashtu mund të jetë problem. Progresi i vazhdueshëm i kapaciteteve të printimit 3D, aftësia për të marrë me lehtësi në internet skedarë dixhitalë pa pagesë për printerët 3D për prodhimin e armëve të zjarrit dhe komponentëve të tyre dhe problemi **në lidhje me rregullimin e shpërndarjes së skedarëve**, mund të kthehen në kërcënim për sigurinë publike.

E vetmja formë kontrolli e menjëhershme që duhet të shqyrtohet mund të jetë mundësia për të konsideruar si shkelje mbajtjen, postimin në internet ose çdo lloj forme e shpërndarjes së "të dhënave teknike" që mund të përdoren për printimin e një arme zjarri ose pjesëve të saj. Mbajtja ose shpërndarja e këtyre të dhënave mund të konsiderohet si publikim i informacionit të paligjshëm dhe në këtë mënyrë mund të kriminalizohet dhe të dënohet siç duhet.

Armët e zjarrit të printuara me teknikën 3D vazhdojnë të mbeten të rralla dhe kapacitetet e tyre mbeten të kufizuara. Për momentin, vjedhja e armës ose blerja e saj në tregun e paligjshëm mund të jetë më e lehtë dhe më pak e kushtueshme sesa printimi i një arme të besueshme me teknikën 3D. Ndaj, edhe për disa vite kjo teknologji mund të vazhdojë të jetë një

burim i papërfillshëm i armëve të paligjshme të zjarrit. Megjithatë, kur të ulen kostot e prodhimit dhe të rritet cilësia, printimi 3D mund të bëhet një zgjidhje me përfitime për prodhimin e paligjshëm të armëve në sasi të vogla. Për këtë arsye, në një të ardhme relativisht të afërt, prodhimi i pakontrolluar, përhapja dhe trafikimi i paligjshëm i armëve të zjarrit të printuara me teknikën 3D kanë shumë gjasa që të kthehen në një kërcënim serioz. Për të luftuar këtë kërcënim të mundshëm mund të merren në konsideratë katër qasjet e mëposhtme:

1. Kontrolli i printerëve 3D që përdoren për prodhimin e armëve të zjarrit

Disa nga regjimet ndërkombëtare për kontrollin e eksporteve, si Regjimi i kontrollit të teknologjisë së raketave (MTCR) dhe Marrëveshja e Vasenarit (MV) në disa raste janë përpjekur të përcaktojnë parametrat teknikë të printerëve 3D që do të përfaqësonin një "cak" mbi të cilin këto printerë 3D do të duhej të kontrolloheshin. Me fjalë të tjerë, eksporti i tyre duhet të miratohet nga një organ shtetëror i autorizuar. Të gjitha këto përpjekje nuk kanë çuar në një vendim përfundimtar, por është e qartë se këto diskutime dhe këto përpjekje do të vazhdojnë. Duhet të theksohet se ky kontroll do t'i referohet vetëm një rrethi të ngushtë printerësh 3D me specifikimet teknike më të larta (d.m.th. shumë pak për qind e printerëve). Kjo nënkupton se **nga këndvështrimi i kontrollit të eksporteve, shumica dërrmuese e printerëve 3D do të vazhdojnë të mos kontrollohen. Bazuar në faktin që shumica e printimit në 3D deri më tani nuk është kontrolluar dhe tashmë ka shumë printerë të shpërndarë në duar të civilëve, rreziku i prodhimit të jashtëligjshëm të armëve të zjarrit ekziston, edhe pse është i kufizuar deri në një farë mase.**

2. Kontrolli i materialeve nga të cilët prodhohen këto armë

Printerët 3D mund të përdorin një gamë të gjerë materialesh duke përfshirë plastikën, rezinat, metalet, qeramikën etj. Megjithatë, preferohen

polimere të ndryshme, nga termoplastika e njohur deri te fotopolimeret e rralla. Ka shumë procese të pluhurit që përfshijnë pluhurat metalike dhe të tjera që përfshijnë përdorimin e letrës dhe fletëve PVC për qëllime prodhimi. **Autoritetet praktikisht e kanë të pamundur që të kontrollojnë materialet që përdorin printerët 3D për prodhimin e armëve të zjarrit, duke qenë se po këto materiale përdoren për prodhimin e të gjitha produkteve të tjera për konsumatorin.**

3. Ndalimi i prodhimit të këtyre armëve

Në shumë vende është hartuar kuadri ligjor për kontrollin ose ndalimin e prodhimit të armëve të zjarrit të përgjithshme dhe nevojiten vetëm rregullime të vogla për të garantuar lehtësisht dhe plotësisht konsiderimin e keqpërdorimit të teknologjisë 3D si shkelje. Situata është e ngjashme në Ballkanin Perëndimor ku ligji ndalon prodhimin e armëve të zjarrit pa miratim paraprak nga qeveria. Gjithashtu, ka dispozita që kërkojnë që çdo armë zjarri duhet të testohet dhe të markohet siç duhet përpara se të vendoset në treg. **Kjo nënkupton se sipas legjislacionit ekzistues, prodhimi dhe përdorimi i armëve të zjarrit 3D tashmë trajtohet si i paligjshëm.**

4. Rritja e kontrollit të skedarëve teknikë dixhitalë mbi bazën e të cilëve prodhohen armët e zjarrit

Aspekti i fundit që duhet marrë në konsideratë është trajtimi si shkelje i përdorimit të skedarëve të "të dhënave teknike", pa të cilët printerët 3D nuk mund të prodhojnë armë zjarri ose pjesë të tyre. Kjo është një fushë në të cilën komuniteti duhet të përqendrojë përpjekjet si një mënyrë për të gjetur një zgjidhje të kënaqshme.

Ndërsa kjo zgjidhje mund të duket drastike, duhet të merret parasysh se përpara lulëzimit të printimit 3D, çdo mënyrë tjetër për të prodhuar armë zjarri kërkonte aftësi dhe përvojë të përshtatshme, burime investimi dhe materialet e nevojshme. Në shumicën e rasteve kombinimi i të gjitha këtyre kërkesave zor se kalonte pa u vënë re kur niste prodhimi. Për prodhimin e armëve të zjarrit nëpërmjet printimit 3D nuk nevojitet asnjë aftësi specifike, asnjë burim ose material dhe as njohuri mbështetëse.

E vetmja formë kontrolli e menjëhershme që duhet të shqyrtohet mund të jetë mundësia **për të konsideruar si shkelje mbajtjen, postimin në internet ose çdo lloj forme e shpërndarjes së "të dhënave teknike" që mund të përdoren për printimin e një arme zjarri ose pjesëve të saj.** Mbajtja ose shpërndarja e këtyre të dhënave mund të konsiderohet si publikim i informacionit të paligjshëm dhe në këtë mënyrë mund të kriminalizohet dhe të dënohet siç duhet.

SEESAC është duke zbatuar **VENDIMIN E KËSHILLIT TË BASHKIMIT EVROPIAN 2013/730/CFSP**, në mbështetje të aktiviteteve të SEESAC për çarmatimin dhe kontrollin e armëve në Evropën Juglindore - projekti EUSAC. Bashkimi Evropian e ka mbështetur SEESAC që prej vitit 2002 dhe projekti EUSAC është pjesë e portofolit të SEESAC për kontrollin e armëve të vogla dhe të lehta (SALW).

Për të mësuar më shumë, jeni të lutur të vizitoni faqen e internetit www.seesac.org

Kjo broshurë është shkruar nga Mirko Kukulj. Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument janë të vetë autorit dhe jo domosdoshmërisht pasqyrojnë pikëpamjet e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal apo të Bashkimit Evropian. Emërtimet e përdorura dhe prezantimi i materialit në këtë botim nuk nënkuptojnë shprehjen e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal apo të Bashkimit Evropian për 1) statusin ligjor të një shteti, territori ose zone, apo për autoritetet ose grupet e armatosura të tij; ose 2) për vijëzimin e kufijve të tij.

SEESAC 



This project is funded by
the European Union



Empowered lives. Resilient nations.

**50
YEARS**

UNDP SEESAC

Bulevar Zorana Đinđića 64, 11070 Belgrade / SERBIA

Telephone: +381 (11) 4155 300

Fax: +381 (11) 4155 499

E-mail: seesac@undp.org

www.seesac@undp.org